

Parazanati – çfarë është kjo?

Parazanati është një ofertë kalimtare (urë) njëvjeçare, gjatë së cilës në mënyrë praktike dhe shkollore përgatiteni për hyrje në arsimimin bazë profesional.

Rreth 3,5 dhe 4 ditë punoni në një ndërmarrje dhe vijoni 1–1,5 ditë shkollën profesionale. Për punën në ndërmarrje merrni rrogë. Në shkollën profesionale paguani materialet për mësim dhe eventualisht për ekskursionë. Në secilin gjysmëvjetor merrni vlerësimet e rezultateve tuaja.

Ose i ndiqni programet e veçanta të parazanatit në shkollën profesionale, të cilat shpesh kombinohen me praktikë dhe stazh në ndërmarrje. Kjo formë e parazanatit është e përhapur shumë në pjesën italiane dhe në atë frankofone të Zvicrës dhe i përgjigjet të të ashtuquajturit vit parapërgatitor për profesion në Zvicrën gjermanofolëse.

A është parazanati zgjedhje e duhur për ju?

Ju keni përfunduar shkollimin e detyrueshëm dhe

- Jeni i moshës midis 15-18 vjeçe (në kushte të caktuara dhe në disa vende deri 20 në vjet).
- Jeni ende në fazën e zgjedhjes së profesionit ose tashmë keni vendosur për një profesion, por ende nuk keni gjetur vend për të mësuar profesionin.
- Për arsye gjuhësore dhe shkollore keni nevojë për një kohë të caktuar parapërgatitore, për të qenë i suksesshëm në arsimimin bazë profesional.
- Jeni i motivuar dhe i gatshëm për të mësuar.
- Keni njohuri themelore gjuhësore në njërën nga gjuhët lokale të vendit, për t'u marrë vesh dhe për të pasur mundësi të ndiqni mësimin.

Si mund të vini deri te parazanati?

Së pari duhet të gjeni një ndërmarrje, e cila ofron parazanati në atë profesion apo fushë të profesionit, në të cilën ju dëshironi të bëni arsimimin bazë profesional. Pastaj, ndërmarrja ku e bëni parazanatin ju paraqet te shkolla përkatëse profesionale. Këtu sqarohet nëse i plotësoni parakushtet për shkollë. Pastaj e lidhni një kontratë për shkollim paraprak me ndërmarrjen ku do të bëni parazanat.

Në disa kantone, kërkimi i një ndërmarrje për parazanat bëhet me mbështetjen e Këshillimores Profesionale, me të cilën së bashku e komplettoni dosjen e aplikimit dhe kërkoni ndërmarrje për parazanat. Këshillimoret profesionale në çdo rast ju mbështesin gjatë kërkimit të një ndërmarrjeje për të bërë parazanatin ose të një programi përkatës të parazanatit.

A është i mundshëm parazanati në secilin profesion?

Po, nëse e gjeni ndërmarrjen përkatëse për parazanat.

Sa është paga gjatë parazanatit?

Nëse bëni paramanat në një ndërmarrje, lartësia e pagës dallon varësisht nga profesioni dhe varet prej rrogës së vitit të parë të arsimimit. Zakonisht merrni 80-90 për qind të pagës së vitit të parë të arsimimit. Lartësia e pagës përcaktohet edhe në kontratën për parazanat.

Me rastin e programeve për parazanat në shkolla me orar të plotë shkollimi nuk merrni rrogë.

Me kontratën për parazanat a keni edhe kontratën për mësim të profesionit?

Jo. Ideale do të ishte bërja e një arsimimi bazë profesional në ndërmarrjen e njëjtë ku keni bërë parazanatin, ose praktikën. Në këtë rast me ndërmarrjen ku mësoni profesionin duhet të lidhni një kontratë për mësim të profesionit.

Çfarë mësoni në shkollën profesionale?

Shkolla profesionale fillon në gusht/shtator dhe zgjatë deri në qershor/korrik të vitit pasues. Sipas rregullit, jeni të ndarë në një klasë të parazanatit dhe merrni mësim të përshtatur për ju individualisht. Ky përqendrohet më së shumti në gjuhë (varësisht prej rajonit: gjermanisht, frëngjisht ose italisht), matematikë dhe arsimim i përgjithshëm. Në programet shkollore të parazanatit përgatiteni në mënyrë intensive përvijimin e praktikave provuese, stazh praktike dhe aplikim për vende për mësim të profesionit.

Në rast të vështirësive gjatë mësimt, do të keni mbështetje individuale nga mësimdhënësit. Për shkollën duhet t'i bëni detyrat e shtëpisë.

Çfarë mësoni në ndërmarrje?

Në ndërmarrje njiheni më për së afërmi me botën e punës dhe mësoni shkathtësitë themelore për profesionin e synuar nga ju. Në ndërmarrje keni në dispozicion një person përgjegjës, i cili ju njofton me punën, ju mbështet dhe ju përcjell gjatë praktikës.

A keni edhe pushime?

Po, në parazanat në ndërmarrje keni pesë javë pushim vjetor. Këto duhet t'i merrni gjatë pushimeve zyrtare të shkollës. Gjatë pushimeve të shkollës nuk keni mësim. Në këtë kohë punoni pesë ditë në javë në ndërmarrje.

Në programet shkollore të parazanatit edhe ju keni pushim gjatë pushimeve zyrtare të shkollës.

Informimi

Informatat i merrni pranë shkollave përkatëse profesionale në kantonin tuaj. Aty i gjeni edhe kontratat për parazanat.